

BIBLIOTEKA

81H-2
54 77

PLAKU
IMALEVE

Ton Shoshi Zef Pali



854-2
SG 77

TON SHOSHI ZEF PALI

Plaku i Maleve

DRAMË NË 5 AKTE

1988

~~333338~~

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

PERSONAT

PREFEKTI

QARKOMANDANTI

SEKRETARI

PAL JAKU — TOGER

SHPENDI — ROJE (kapter)

ZHIVKOJA — AGJENT I KONSULLATES SËRBE

LACA — LAJMËTAR I PREFEKTIT

MICANI — MALESOR

SALIU — MALESOR

BAJRAM CURRI

SADRIA — BABA I SHPENDIT

BJESHKA — MOTRA E SHPENDIT

KEÇI — MALESOR

LENA — NANA E SHPENDIT

KADRI MEHMETI

TOGERI

MAJORI

KAPITENI

OFICERI I

OFICERI II

OFICERI III

NJË OFICER
CENOJA
ÇENTRALISTI
KAPTER SELIMI
BINAKU
ZEJNUNI
FSHATARI I
FSHATARI II
FSHATARI III
DODA
HYSENI
I DELEGUEMI
PLAKU

POPULL, MALESORË, PUNETORË, USHTARE
E OFICERE.

AKTI I

Në zyrën e prefekturës së Shkodrës. Pajisje luksoze. Në mur varen portreti i Skërnderbeut dhe tabllo që paraqesin kostume të krahinave të ndryshme të prefekturës së Shkodrës. Kur hapet sipari prefekti bisedon me qarkomandantin. Jashtë dëgjohet zhurmë dhe zane:

Dilni, Zotni prefekt....

...duem armë!...

... Rroftë Shqipnia...

.... Duem liri!...

(Ndërkaq prefekti sillet nëpër dhomë ndërsa qarkomandanti mbështetet mbi bërryla me krye ndër duer. Në koridor mbas dere qëndron Shpendi si roje)

PREFEKTI — Nuk më pëlqen fare kjo zhurmë.

QARKOMANDANTI — Edhe mue më shurdhon veshët... por ju kërkojnë.

PREFEKTI — E ç'tu them, zotni qarkomandant?

QARKOMANDANTI — Ky asht problemi...

PREFEKTI — Sikur vetëm ata e duen Shqipni në!... Sikur s'na dhimbset ne liria! Se mos ua sjellim ne Zogun në Shqipni.

ZANE — Duem armë! (këndohet: «Për Mëmëdhenë», etj)

QARKOMANDANTI — Situata nuk pret.

PREFEKTI — Qeveria nuk mori masa, apo të shpallem unë Kryeministër?

QARKOMANDANTI — Sidoqoftë... si prefekt që jeni...

PREFEKTI — Unë nuk vendos, zotni qarkomandant; nuk marr përgjegjësi me armatosë popullin. Prandaj e shoh të arësyeshme të presim se ç'do të thotë paria në mbledhje. (**merr me dalë**)

QARKOMANDANTI — Më falni, zotni prefekt. Kisha me dëshirue me dijtë mendimin tuej personal për qëndrimin që duhet të mbajmë...

PREFEKTI — Sido që të zhvillohen ngjarjet, turmës nuk do t'ja lëshojmë drejtimin.

QARKOMANDANTI — Shumë me vend, zotni prefekt.

PREFEKTI — Atëhere merr masa me shpërnda turmën; fuqiza rojen e prefekturës; gjatë kohës, që bahet mbledhja, mos len të qarkullojnë grupe njerëzish.

QARKOMANDANTI — Si urdhron! (**hyn sekretari**)

SEKRETARI — Konsulli italian nuk do të vijë në mbledhje.

PREFEKTI — Si mundet me kenë?

SEKRETARI — Nuk ka udhëzime nga legata, më tha.

PREFEKTI — (**me nervozitet**) Asht e dijtun. Deshën të merren vesh me rusët dhe u armiqësuem me shtetet që na ndihmonin e përkrahnin. (**qarkomandantit**) E unë kisha besim te konsulli se do të na jepte ndonji shpresë... në këto çaste të rrezikshme.

SEKRETARI — Shumë prej anëtarëve të parisë
ju presin në sallon.

PREFEKTI — Shumë mirë. (Zhurmë jashtë)

SEKRETARI — Ndëgjoni q'bahet. Ata të «Shoq-
nisë Puna» i fryjnë zjarrit.

QARKOMANDANTI — Kujtojnë se vetëm punë-
torët e duen Shqipninë (sekretarit) Urdhno-
ni toger Palin të paraqitet. (sekretari del)
Nuk asht keq, zotni Prefekt, të flisni ma
përpara për të preqatitë terrenin.

PREFEKTI — Për të preqatitë mbledhjen, thue ti?

QARKOMANDANTI — Pikërisht.

PREFEKTI — Për luftë a për paqe?

QARKOMANDANTI — Pikërisht.

PREFEKTI. — Ju si do të mendojshit?

QARKOMANDANTI — Do të isha në dispozicio-
nin tuej si ushtarak.

PREFEKTI — Don me thanë me i pritë me zjarr
ushtritë e Zogut?

QARKOMANDANTI — Po qe nevoja...

PREFEKTI — Ose me u urue mirëseardhjen...
(qesh) Këtë nuk do ta baj kurrë përderisa
ka vend në botë ku mund të ha një kaf-
shatë me nder.

QARKOMANDANTI — (ban shej me dorë) Me
ça?... Por ndoshta paria do të vendosë va-
riantin e parë: luftë për vdekje ushtrive të
Zogut.

PREFEKTI — (tue qeshë) Më provokove. Ku i
leverdis Haxhi Beut, Zija Beut apo tregëta-
rëve me rrezikue çifligjet e magazet me
luftë! Sigurisht unë do të paraqitem intran-
zigjent.

QARKOMANDANTI — (qesh) Politikë?

PREFEKTI — Po ju la që të më zavendësoni dhe për çdo të papritun të më veni në dijeni.

QARKOMANDANTI — Si urdhnon! (prefekti del)
ZANE — (Fillon kanga «O trima luftëtarë... (Bjen zilja e telefonit)

QARKOMANDANTI — Alo!... po, këtu Prefektura... Kopliku? Çka kërkojnë? S'asht puna e tyne. Mendojmë na. Nuk binden?... Po ju a i keni xhandarët? Shpérndajini me forcë. Kupton? Arrestoni ndonji e të tjerët do të rrinë si pulat e laguna (Hyn toger Pali).

PALI — (tue nderue) Më kërkuet, zotni qarkomandant?

QARKOMANDANTI — A nuk të binë në vesh këto kangë? Sikur të ishim në kohën e Turqisë. Merr forca e shpérndaje menjihërë popullin. Ndaloni qarkullimin nëpër qytet.

PALI — (nderon) Si urdhnon! (në këtë kohë hyn Shpendi e njofton)

SHPENDI — Një njeri kërkon me u takue me ju.

QARKOMANDANTI — Mirë, mirë... Toger Pal, zbato urdhnin menjëherë. (Pali del, Zhivkoja duket në skenë dhe me urrejtje ndëgjon kangën që ndihet nga jashtë.

QARKOMANDANTI — (Shpendit) Kush asht ai?

SHPENDI — Nji i panjoftun (hyn Zhivkoja)

ZHIVKOJA — T'u ngjatëjeta, zotni qarkomandant.

QARKOMANDANTI — T'u ngjatëjeta! Ç'ka urdhnoni? (në këtë kohë Zhivkoja shikon me sy vjedhurazi nga Shpendi dhe len me kuptue se don që ai të largohet).

QARKOMANDANTI — Delni pak, kapter! (Shpendi del).

ZHIVKOJA — Mos u shqetësoni nga unë, zotni qarkomandant.

QARKOMANDANTI — Kështu e kam zakon me pritë në kambë.

ZHIVKOJA — Ju admiroj për sjelljen korrekte që tregoni ndaj atyre që paraqiten tek ju, pse të gjithë për nevoja vijnë.

QARKOMANDANTI — C'dëshiron zotni?

ZHIVKOJA — Sigurisht për diçka me randësi kam ardhë.

QARKOMANDANTI — Kush jeni ju?

ZHIVKO — Do t'jua tregoj edhe emnin, por ndoshta më pyetët pak si shpejt.

QARKOMANDANTI — (pak si i shqetësuem) Atëhere urdhroni e rrini që të flasim ma lirshëm.

ZHIVKOJA — (ulet) Më vjen shumë mirë që në një kohë të tillë, siç asht kjo e sotmja, të takohen dy miq të vjetër!

QARKOMANDANTI — Nuk mbaj mend t'ju kem njoftë ndonjë herë në jetën time.

ZHIVKOJA — (në formë tregimi) Një herë një njeri kishte një djalë të sëmundë dhe e kishte sjellë në Cetinë për shërim. U gjet një zëmërmirë që e ndihmoi dhe e shpëtoi nga disa të paprituna, që i dolën në doganë dhe në polici. E pastaj e mori edhe në shtëpinë e vet.

QARKOMANDANTI — (e shiken thellë) Ti?... Zhivko?...

ZHIVKO — Po, vetë. (përqafohen)

QARKOMANDANTI — Ku gjinden, Zhivko.... ku banoni?

ZHIVKOJA — Ndër këto ditë kam pasë fatin të banoj këtu në Shkodër, në qendër të qytetit... për ballë furrës së Belikut.

QARKOMANDANTI — Mos jeni njeri i konsullatës?

ZHIVKOJA — Po.

QARKOMANDANTI — Sigurisht keni punë me prefektin... (*ngrihet*) po e njoftoj.

ZHIVKOJA — Prefekti e ka mendjen e zemrën në Itali. Ai sigurisht pregetitet për të ikë. Unë kam punë me ju, që do të qendroni këtu. (*Hyn Pali*)

PALI — Zotni qarkomandant! Çdo gja po zbatohet simbas urdhnit.

QARKOMANDANTI — Mirë, Pal! Më pritni pak jashtë. (*Pali nderon e del*) (*Zhivkos*)... Ju kishit atëhere një pamje tjetër.

ZHIVKOJA — (*qesh*) Edhe njeriu si lamshi i dhet, sillet e sillet pa nda.

QARKOMANDANTI — Folni haptazi, Zhivko.

ZHIVKOJA — Nuk më ka mungue kurrë singjeriteti, aq ma tepër më ju sot. Besoj se nuk do të zbuloj ndonjë sekret në qoftë se ju them se Qeveria juej po e përfundon jetën e saj të shkurtën.

QARKOMANDANTI — Ashtu duket.

ZHIVKOJA — (*tue ba një hark me dorë*) Ja, rrëth e rrëth ushtarët e Zogut që presin urdhnin e komandantit të tyne.

QARKOMANDANTI — Mundet.

ZHIVKOJA — Ta them si mik. Banu me ne! Çdo qëndresë vetëm random mbi shpatullat për të nesërmen.

QARKOMANDANTI — Nuk mendohet për një qëndresë.

ZHIVKOJA — E dij... por unë kam një kërkesë shumë të randësishme... Që të meritoni miqësinë tonë, që të baheni pjesëtar i luftës sonë... këtë duhet ta kryeni.